



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prinjeno Më/Dana 02-12-2011			
Nr. i organit Org. broj	Numri/broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednos
01-03/2145			



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Gazeta zyrtare nr 28/2008, dhe nenit 36.1) të Statutit të Komunës së Vitisë nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 23.11.2011 aprovon këtë:

V E N D I M
PËR MARRJEN NËN MENAXHIM TË OBJEKTIT “SHKOLLA MUZE ISLAM PIRA”
NË POZHERAN

Neni 1

Me këtë Vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë, merr nën menaxhim objektin e shkollës Muze “Islam Pira” në Pozheran të Komunës së Vitisë.

Ringritja e objektit të shkollës së parë shqipe në Pozheran të Komunës së Vitisë është bërë nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport e Republikës së Kosovës dhe është emëruar “Shkolla Muze – Islam Piraj”

Neni 2

Marrja nën menaxhim ka për qëllim ruajtjen dhe funksionimin e këtij muzeu, i cili bënë pjesë në listën e monumenteve të mbrojtura nga shteti – Republika e Kosovës.

Neni 3

Mjetet financiare për ruajtjen dhe funksionimin e „Shkollës Muze Islam Pira“ sigurohen nga buxheti i Komunës së Vitisë – planifikohen dhe ndahen në Buxhetin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

O1.Nr. _____
Viti, 01.12.2011



KRYESUESI I KUVENDIT
Skenderbe Hebibaj